



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 28 qershor 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi Radmila Vujoviq, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selvije Halimi dhe Kolë Berisha.

Munguan: Gani Geci dhe Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Fejzullah Hasani – Gjykata Supreme, Lavdim Krasniqi – IGJK, Salih Mekaj – Gjykata e Qarkut, Pejë, Bardhyl Hasanpaj – NDI, Bedri Bahtiri – MD, Enver Peci – KGJKP, Merita Stublla Emini – USAID, Blerta Bejtullahu – ICO, Lejla Selimi – OSBE, Teuta Rexhepi – Bota sot, Gita Lushi – Kosova sot, Merita Mustafa – KDI, Isuf Zejna – KDI, Astrit Hoti – KGJK, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje propozohet ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14 qershorit 2010,
3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të propozuara nga grupi i punës i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në Projektligjin për gjykatat,
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese nr. L-181,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 14 qershorit 2010,

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14 qershor 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të propozuara nga grupi i punës i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në Projektligjin për gjykatat

Kryetari - E përshëndeti prezencën e pjesëmarrësve në mbledhjen e Komisionit dhe i njoftoi se grupi punues ka punuar sipas dinamikës së përcaktuar në amendamentimin e këtij P/L, në bashkëpunim me ekspertet e angazhuar nga Komisioni, si dhe me ndihmën e të gjithë atyre të cilët kanë dhënë kontributin në funksion të plotësimit të përmbajtjes së tij. Kërkoj nga anëtarët e Komisionit dhe pjesëmarrësit e tjerë që nëse kanë ndonjë propozim shtesë t'i paraqesin për shqyrtim para se të miratohen dhe të procedohen për shqyrtim të mëtejshëm. Propozoi që neni 2, pika 1.7 të hiqet, që ka mbetur të diskutohet në Komision.

Ibrahim Makolli - Duke ju referuar amendamentit 2, neni 2, paragrafi 1, pyeti se a është e domosdoshme që të përcaktohet se më kënd bashkëpunon KGJPK - ja ?

Bajram Kosumi - Propozoi korrigjimin që në amendamentin 2, neni 2, paragrafi 1, lidhëza “ ose “ të zëvendësohet me “ dhe “ sepse ndryshon përmbajtjen e këtij paragrafi.

Adem Hajdaraj - Propozoi që amendamenti 8, neni 11, paragrafi 2, të korrigjohet gjuhësisht fjala “ dhënin “ të zëvendësohet me “ dhënie “.

Rreth amendamentit 8, neni 11, diskutuan edhe Ibrahim Makolli e Armend Zemaj dhe u vendos që të mbetet ashtu siç është propozuar amendamenti i Komisionit me korrigjimin gjuhësor dhënë nga Adem Hajdaraj.

Ibrahim Makolli - Në fjalën e tij të serishme ju referua amendamentit 9, nenit 12, duke propozuar që përveç themelimit të departamentit për të mitur në kuadër të Gjykatave Themelore të parashihet edhe në kuadër të Gjykatës së Apelit.

Adem Hajdaraj - Propozoi që në amendamentin 9, neni 12, paragrafi 7, fjala: “ të caktuara “ të zëvendësohet me: “ përkatëse “.

Armend Zemaj - Shprehu mendimin se amendamenti i propozuar nga deputetja Nekibe Kelmendi, që i referohet nenit 12, paragrafit 8, që është propozuar të hiqet ka logjikë, sepse ndonjëherë mund të paraqitet konflikt interesi dhe kjo mund të keqpërdoret nga ana e kryetarit të gjykatës, sepse mund të këtë individë të caktuar që nuk pajtohen që një gjyqtar, të cilit ju ka caktuar lënda dhe dëshiron ta transferojë në një gjykatë tjetër.

Komisioni nuk e përkrahu amendamentin e deputetes Nekibe Kelmendi, kundër ishte Armend Zemaj.

Ibrahim Makolli - Ju referua amendamentit 14, neni 17, ishte i mendimit se nuk do të duhej të përfshihej në ligj: “ *propozimi gjithëpërfshirës për zgjedhjen se statusit të Kosovës*”, sepse ajo nënkuptohet.

Kryetari – *Tha se në tërë P/L duhet të vlejë se te gjykatat themelore, kur përmendet paneli, aty duhet të jetë trup gjykues, nuk ka panel te gjykatat themelore.*

Armend Zemaj- Theksoi se edhe në grupin punues neni 22 i P/L ka qenë i diskutueshëm, i cili është diskutuar edhe nga ekspertët dhe ndërkombëtares. Kjo çështje është diskutuar rreth kompetencave të Gjykatës Supreme, sepse mungon një propozim i plotë që do ta plotësojë këtë nen, ai paraqiti propozimin për nenin 22, për t’u diskutuar nga Komisioni.

Ishte i diskutueshëm neni 22, ku diskutuan Ibrahim Makolli, Bajram Kosumi dhe Ramadan Gashi, pas diskutimeve që u zhvilluan dhe me sqarimet e dhëna nga ekspertët neni 22 riformulohet.

Adem Hajdaraj - Ishte i mendimit që në nenin 26, paragrafi 1, pika 5 të përfshihen trajnimet për gjyqtarë deri në një moshë të caktuar.

Ibrahim Makolli - Propozoi që amendamenti 21, neni 26, paragrafi 1.7 të jetë : “ *Te mos jetë i dënuar për vepër penale të përcaktuara me ligjin në fuqi* “, ndërsa fjala: “*përgjashtimisht për kundravajtje*” të hiqet.

Adem Hajdaraj - Propozoi që në nenin 26, paragrafi 3, termi: “ *përvojë akademike nuk është e definuar qartë* ”, prandaj ishte i mendimit që duhet të hiqet.

Bajram Kosumi - Ju referua nenit 27 paragrafi 1, rreth kriterëve plotësues për gjyqtarë dhe ishte i mendimit se këto kriterë duhet të jenë më të buta në mënyrë që të ju mundësohet gjykatësve të rinj të zgjedhën, sepse në bazë të këtij kriteri asnjë gjykatës i shkolluar pas luftës nuk mund t’i plotësojë këto kriterë.

U diskutua neni 26, paragrafi 3 dhe u vendos të mbetet si në P/L, ndërsa rreth nenin 27 diskutuan Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Bajram Kosumi dhe u pajtuan që në titull fjala “ shtesë “ zëvendësohet me fjalën “ plotësuese “.

Armend Zemaj - Sqaroi se në grupin punës neni 29, paragrafi 1.7, ku është paraparë: “ *paga bazë jo më pak se 70 % të pagës së kryetarit të Gjykatës Themelore*” të rritet për 10 %.

Selvie Halimi - Duke folur për bashkëpunëtorët profesionalë tha se me ligjet aktuale ekziston baza ligjore për bashkëpunëtorët profesionalë, mirëpo me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet ligji paraprak. Prandaj edhe këtu do të duhej të ishte baza ligjore, jo të përcaktohet numri i tyre, vetëm baza ligjore duhet të përfshihet.

Ishte e diskutueshme çështja e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe praktikantëve dhe u propozua që me një nen të veçantë të vendoset baza ligjore, ku titulli nenit do të ketë këtë formulim: “ *Bashkëpunëtorët*

profesionalë dhe praktikantët”, ndërsa paragrafi të formulohej: “ Bashkëpunëtorët profesionalë dhe praktikantët gjyqësorë përcaktohen me rregulloren e Këshillit Gjyqësor të Kosovës “.

Ramadan Gashi - Propozoi që në nenin 33, paragrafi 4, fjalët: “ mbi substancën, meritat apo shqyrtimet “ të zëvendësohet me fjalët: “ mbi provat apo faktet”.

Ibrahim Makolli - Propozoi që në nenin 33, paragrafi 4, fjalët: “ mbi substancën, meritat apo shqyrtimet “ të zëvendësohet me: “ përmbajtjen, provat dhe vendimet”.

Kryetari - Duke ju referuar nenit 41, propozoi të riformulohet si vijon: “ Ky ligj hynë në fuqi më 1 janar 2013 me përjashtim të neneve 29, 35, 36, 38, dhe 40 të cilat do të hynë në fuqi më 1 janar 2011”. Ose **“Ligji hynë në fuqi më 1 janar 2011 për nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40, kurse nenet e tjera fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2013”** .

Selvi Halimi - Propozoi që neni 41 të riformulohet si vijon: “Ky ligj shpallet në Gazetën Zyrtare dhe hynë në fuqi më 1 janar 2013, me përjashtim të neneve 29, 35, 36, 38, dhe 40, të cilat do të hynë në fuqi më 1 janar 2011”. Ose versioni tjetër mund të jetë: “ Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare dhe hynë në fuqi e zbatohet nga 1 janari 2013, përjashtimisht që hynë në fuqi dhe zbatohen nenet 29, 35, 36, 38, dhe 40 nga 1 janari 2011” .

Bardhyl Hasanpapaj - Duke u ndërlidhur me parafolësen propozoi këtë riformulim: “Ky ligji hynë në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare dhe fillon të zbatohet në vitin 2013, me përjashtim të neneve 29, 35, 36, 38, dhe 40, të cilat do të hynë në fuqi më 1 janar 2011” .

Ishte i diskutueshëm edhe neni 42, paragrafi 1 dhe i njëjti u riformulua si vijon: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji për Gjykatat e rregullta të KSAK, Rregulloret e UNMIK - ut dhe ligji për kundravajtjet”.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e propozuara nga grupi punues i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi ,në P/L për gjykata, të njëjtat procedohen për shqyrtim të mëtejme.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese nr. L-181

Kryetari paraqiti për shqyrtim Propozimamendamentet në Projektligjin për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese që të konstatohet baza juridike dhe kërkoi përkrahjen nga anëtarët e Komisionit, sepse amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni vlerëson se Projektligji për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese dhe amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

5. Të ndryshme.

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 50

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni